

Mafia në botimet artistike (2)

Krijuesit, peng i botuesve

Përgjithësisht ata pak autorët që botojnë në kuadër të ndonjë shtëpie botuese pothuajse nuk kanë të drejtë ta shtrojnë çështjen e honorarit edhe nëse vepra e tij financohet nga Ministria e Kulturës

Koha Shkëlzen HALIMI


Për botimin e tirazhit sa për sy e faqe, Zekerija Ibrahim, thotë se "logaria e shtypshkronjës për botuesit seriozë thotë se nuk është dobiprurëse nëse prej një libri botohen më pak se 300 ekzemplarë, optimale është tirazhi 500, ndërsa mesatarja e tregut tonë, që libri të jetë i pranishëm në treg së paku 3-4 vjet, është 1000 ekzemplarë. Por, për qëllime profiti ka "botues" që shtypin vetëm nga 50 ekzemplarë sa për t'i arsyetuar mjetet që i kanë marrë".

Ndonëse në Ministrinë e Kulturës thonë se kanë kontroll të tirazheve, intrigat e botuesve asnjëherë nuk janë penalizuar dhe mbase teknikisht është e pamundur të kontrollohen të gjitha shtëpitë botuese.

Pjesë e intrigave në financimin e botimeve letrare është edhe segmenti i quajtur "shtëpitë botuese familjare", të cilat shtojnë përfitimet materiale. Ka shumë raste që si themelues të shtëpisë botuese pos tregtarit, të paraqitet edhe bashkëshortja e tij, pastaj djali i madh, djali i vogël nusja e djalit, vajza. Pra, brenda një familje të ketë edhe gjashtë (6) shtëpi botuese.

Mund të merren me mend përfitimet me kusht që të përkrahen vetëm nga 3 tituj. Me 18 tituj përfitim për standardet e Maqedonisë do të ishte më shumë se i mirë dhe i mjaftueshëm për një familje prej gjashtë anëtarëve që të jetojnë pa brenga gjatë tërë vitit. E keqja e gjithë kësaj është se nuk ka transparencë në ndarjen e mjeteve. Në medime publikohen vetëm titujt, ndërkaq jo edhe shumat për çdo titull.

Zekerija Ibrahim edhe për këtë çështje ka vërejtje dhe thotë se "mjetet ndahen nga një komision që formohet në Ministrinë e Kulturës, ndërsa mënyra sesi ndahen mjetet është krejt jotransparente. Askush nuk e di pse, fjala bie, përkthimi në maqedonisht i romanit të parë të letërsisë shqipe, "Bardha e Temalit", nuk financohet as me harxhimet e shtypit, ndërsa ndonjë libër me poezi i ndonjë autori krejt të panjohur merr para sa për të blerë një veturë. Sepse, kjo është vetëm në dorë të atyre që janë në komisionin e Ministrisë së Kulturës", thotë



E keqja e gjithë kësaj të keqe është cilësia tepër e dobët e librit shqip. Prandaj, imponohet nevoja që urgjentisht të ndryshohet kjo praktikë. Të mos u lejohet konkurrimi i botuesve, por autorëve. Pastaj autorët le të vendosin se cila shtëpi botuese t'ua botojë librat. Ose, ndoshta duhet vepruar si gjithkund në botë, ku shteti nuk e financon librin artistik, por kjo i lihet konkurrencës, ku zakonisht mbijetojnë ata që dinë publikut t'ia ofrojnë librin më të mirë. Në këtë mënyrë do të krijohet një rend që do të sillte cilësi të lartë artistike

Ibrahimi.

Selajdin Salihu thotë se "praktika ka dëshmuar se deri tani janë derdhur të hollat te dy apo tre botues, që, për ironi, janë më të zëshëm dhe më shumë bëjnë kinse kritikojnë. Ata nuk kanë të drejtë morale ta kritikojnë Ministrinë e Kulturës, sepse kanë marrë qindra mijëra euro prej saj, por jo dhe autorët e librave. Sikur shkon puna do të ndodhë që secili shkrimtar do bëhet botues i librave të tij. Kështu, së paku, nuk do të bëhet pre e botuesve. Duhet shtuar, gjithashtu, se Ministria e Kulturës nuk është aspak transparente, për sa kohë publikon vetëm titujt e librave, por jo shumën e mjeteve financiare për një libër. Ndonjë libër financohet me qindra mijë denarë dhe një libër serioz me mjete qesharake. Pse kjo Ministri nuk i bën publike shifrat? Sepse atëherë do të shihet se kush sa ka përfituar. Atëherë do të dalë gjithçka në sipërfaqe. E sa për mjetet që i ndahen kulturës maqedonase dhe asaj shqiptare të mos flasim. Dallimi është drastik. Shqiptarët nga gjithë ai buxhet marramendës nuk marrin as 5 për qind. Ja përse kjo ministri nuk i publikon shifrat", thotë Salihu.

Tash për tash duket se nuk ka mekanizëm për ta kontrolluar këtë keqpërdorim, sepse po të kishte, mesiguri do të ishim dëshmitarë të penalizimit të ndonjë botuesi. Ministria e Kulturës,

thotë Ibrahim, është në dorë të shtetit një-etnik maqedonas, ndërsa kultura shqiptare, librat shqipe, mbesin të kontrolluara nga persona krejt jokompetentë për ta bërë këtë. Ata zakonisht janë njerëz që nuk janë aty për shkak të përvojës botuese ose si njohës të vlerave librore, por thjesht për shkak të përshatshmërisë politike ndaj pushtetit, mendon Ibrahim.

Ndërkaq Saljadin Salihu ka një mendim tjetër. Ai shton se "mjetet duhet ndarë jo për libra derdimenësh, që shpesh na dalin në listën e librave të financiar, por ato të holla do t'i kisha orientuar në libra të domosdoshëm për një kulturë: enciklopedi të ndryshme, fjalorë, krestomaci, studime serioze, vepra që do të zgjidheshin nga një komision eminent i ekspertëve, pastaj komplete veprash, libra të përkthyer (të përkthyesve të verifikuar), por edhe ribotime të veprave të çmueshme (pse të mos ribotohej Iliada dhe Odiseja, vepra komplete e Konicës etj.), kuptohet në bashkëpunim me Tiranën dhe Prishtinën. Kjo sepse

këto libra janë të domosdoshme për kulturën shqiptare, kurse kultura dhe letërsia shqiptare është një, e pandashme dhe me disa sensibilitete krijuese, që është pasuri për sistemin tonë letrar dhe kulturor".

Por, nuk mendojnë kështu edhe pseudo-botuesit shqiptarë, të cilët nuk interesohen të bëjnë asnjë sallon shitjeje (me përjashtim të Sallonit "Vatra" në Shkup), asnjë rrjet shpërndarjeje të librit, sepse nuk e kanë këtë qëllim. Shtëpitë botuese shqiptare ekzistojnë vetëm për të konkurruar në konkursin e Ministrisë së Kulturës dhe jo të shpërndajnë librin që e botojnë.

Në periudhën 20 vjeçare të fazës së tranzicionit (që assesi nuk po përfundon) në Maqedoni, ka patur dhe ende ka pseudo-botues që keqpërdorin krijuesit e rinj, përkatësisht ata që botojnë për herë të parë. Këta të rinj bien pre e këtyre botuesve, të cilët pa e verifikuar fare cilësinë e krijimeve, e udhëzojnë "kurbanin" e tyre se duhet t'i paguajë harxhimet e shtypit në tirazh prej 1000 ekzemplarë, duke ia llogaritur edhe harxhimet e recensentit, lektorit, kopertinën e kështu me radhë, që arrijnë deri më 2000 euro. Ndërkaq çmimi real nuk i tejkalon 1000 eurot.

Përgjithësisht ata pak autorët që botojnë në kuadër të ndonjë shtëpie botuese pothuajse nuk kanë të drejtë ta shtrojnë çështjen e honorarit edhe nëse vepra e tij financohet

nga Ministria e Kulturës. Dihet botërisht se janë dytri shtëpi botuese ("Logos - A", "Vatra" e ndonjë tjetër) që u qëndrojnë besnik marrëveshjeve, qofshin ato edhe simbolike, në raportin botues - autor.

"Krijuesit janë bërë peng i botuesve. Duhet t'u nënshtrohen rregullave të tyre, nëse duan të botojnë diçka. Në shtëpitë më serioze kjo është e rregulluar me marrëveshje mes dy palëve, por te botuesit fiktiv, ky është nocion i panjohur", thotë Zekerija Ibrahim, ndërkaq Saljadin Salihu shton "për sa kohë me politikën kulturore udhëheqin ata që botojnë e nuk lexojnë, ne do bëhemi vetëm spektatorë të improvizimeve; do të bëhemi spektatorë të manovrimeve të botuesve që janë shndërruar në çerdhe përfitimesh personale".

E keqja e gjithë kësaj të keqe është cilësia tepër e dobët e librit shqip. Prandaj, imponohet nevoja që urgjentisht të ndryshohet kjo praktikë. Të mos u lejohet konkurrimi i botuesve, por autorëve. Pastaj autorët le të vendosin se cila shtëpi botuese t'ua botojë librat. Ose, ndoshta duhet vepruar si gjithkund në botë, ku shteti nuk e financon librin artistik, por kjo i lihet konkurrencës, ku zakonisht mbijetojnë ata që dinë publikut t'ia ofrojnë librin më të mirë. Në këtë mënyrë do të krijohet një rend që do të sillte cilësi të lartë artistike. Njëkohësisht do të kishim ashpërsim të "luftës" për t'i përfituar autorët më të mirë me veprat bestseller dhe, kuptohet, do të kishim një raport të ri mes botuesit dhe shkrimtarit. Natyrisht, do të zhdukej edhe ndikimi i politikës që në botimet, sidomos shqipe, ka bërë dëm të pariparueshëm. Njëkohësisht do të merrnin fund veprimet mafioze të tregtarëve që kanë shtëpi botuese, të cilët shpesh, pa fijen e



Saljadin SALIU

"Mjetet duhet ndarë jo për libra derdimenësh, që shpesh na dalin në listën e librave të financiar, por ato të holla do t'i kisha orientuar në libra të domosdoshëm për një kulturë: enciklopedi të ndryshme, fjalorë, krestomaci, studime serioze, vepra që do të zgjidheshin nga një komision eminent i ekspertëve, pastaj komplete veprash, libra të përkthyer (të përkthyesve të verifikuar), por edhe ribotime të veprave të çmueshme (pse të mos ribotohej Iliada dhe Odiseja, vepra komplete e Konicës etj.), kuptohet në bashkëpunim me Tiranën dhe Prishtinën. Kjo sepse këto libra janë të domosdoshme për kulturën shqiptare, kurse kultura dhe letërsia shqiptare është një, e pandashme dhe me disa sensibilitete krijuese, që është pasuri për sistemin tonë letrar dhe kulturor".

turpit thonë se angazhohen në emër të popullit.

Me të drejtë Selajdin Salihu thotë se ata që i kemi zgjedhur nuk e dinë se kultura është mbi gjithçka, sepse "babai" i BE-së, Zhan Mone, tha: "Po të filloja edhe njëherë, atëherë do t'ia nisja nga kultura". Kurse, në konstat të kësaj, Zekerija Ibrahim thotë: "nëse diçka botohet jashtë politikës, do të jetë sukses i madh. Mbase kjo duhet të jetë vlera e vërtetë".

Në një realitet të këtilë të gërditshëm, ku edhe libri i nënshtrohet "ligjeve" të mafisë, është vështirë të bësh më shumë, sepse është pikërisht kjo mafi që e ngulfat edhe këtë të vërtetë. S'ke si të protestosh ndryshe, pos si Osman Ahmeti, i cili vendosi që Shtëpinë e tij botuese "Sub-kult" të shlyejë nga Regjistri qendror i ndërmarrjeve në Maqedoni. Është kjo në protestë e dhimbshme, por edhe e tmerrshme. (Fund)

P.s.

Kjo storje hulumtuese është realizuar me mbështetjen e projektit SCOOP dhe Shoqatës daneze të gazetarëve hulumtues.